Newsletter
NËNTOR 2026
VITI VII
E DREJTA PËR INFORMIM

E drejta për informim, parakusht për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen mjedisore

Garantimi i aksesit në informacion dhe transparenca e institucioneve publike ishin në fokus të kontributit të Zyrës së Komisionerit në workshop-in kombëtar për forcimin e pjesëmarrjes publike në vendimmarrjen mjedisore, të zhvilluar në Tiranë. Aktiviteti u organizua në kuadër të projektit "Konvergjenca e Drejtësisë Klimatike dhe Mjedisore në Ballkanin Perëndimor". Përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, institucioneve mbikëqyrëse, shoqërisë civile dhe ekspertë diskutuan mbi pengesat që kufizojnë përfshirjen e qytetarëve dhe mekanizmat për përmirësimin e konsultimeve publike.

Zyra e Komisionerit u përfaqësua nga znj. Rovena Sulstarova, Drejtor i Përgjithshëm për të Drejtën e Informimit, e cila mori pjesë në panelin mbi identifikimin e pengesave dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale. Në diskutimin e saj ajo trajtoi kompetencat e Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, me fokus te detyrimet për transparencë proaktive dhe rëndësia e Programit të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore në informimin e publikut mbi proceset e konsultimit dhe vendimmarrjen institucionale.






Në këtë kontekst, znj. Sulstarova theksoi se transparenca nuk duhet të kufizohet vetëm te publikimi i njoftimeve për konsultim, por duhet të përfshijë edhe informacionin mbi rezultatet e konsultimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar propozimet e qytetarëve. Publiku duhet të ketë mundësi të kuptojë jo vetëm se cilat vendime janë marrë, por edhe se si kontributet janë vlerësuar dhe reflektuar në procesin e vendimmarrjes.

Në qendër të takimit ishte diskutimi i projektudhërrëfyesit për Llogaridhënien dhe Mekanizmat e Reagimit 2026-2030, i mbështetur në vlerësimet e projektit pilot të Bashkisë Elbasan. Ky dokument synon të forcojë transparencën dhe llogaridhënien në qeverisjen mjedisore, përmes përmirësimit të praktikave të konsultimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Në këtë kuadër, Programet e Transparencës dhe Indeksi i Transparencës Proaktive përfshihen në projektudhërrëfyes, si instrumente referimi për vlerësimin e transparencës dhe aksesit në informacion. Këto masa synojnë të forcojnë lidhjen ndërmjet informimit, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies në çështjet mjedisore, në përputhje me parimet e Konventës së Aarhusit dhe prioritetet e integrimit evropian të Shqipërisë.

Komiteti i Planifikimit për ICIC 2027, zhvillohet online takimi i parë

Zhvillimi i takimit të parë të Komitetit të Planifikimit për Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) 2027 shënoi fillimin e procesit të koordinimit dhe përgatitjeve intensive për zhvillimin e edicionin të 18-të të aktivitetit më të rëndësishëm global për aksesin në informacionin publik.

Konferenca parashikohet të mbahet në datat 28 - 30 qershor të vitit të ardhshëm, ndërsa tema e këtij edicioni do të jetë *"Forcimi i besimit të publikut nëpërmjet aksesit në informacion"*. Në këtë mënyrë, vendosja në qendër e rolit të pazëvendësueshëm të transparencës dhe të së drejtës për informim ka për qëllim të nxisë forcimin e besimit të publikut te veprimtaria e institucioneve.



Gjatë takimit të parë u diskutuan aspekte të organizimit dhe përmbajtjes së Konferencës, konkretisht dokumenti konceptual, i cili pritet të miratohet së shpejti. Ndër të tjera, u theksua se krahas diskutimeve institucionale dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet komisionerëve dhe autoriteteve për të drejtën e informimit, të konsiderohet edhe perspektiva e një individi, për të cilin aksesi në informacionin publik ka qenë thelbësor ose ka luajtur një rol vendimtar në jetën e tij.

Në rend të ditës ishin edhe diskutimet mbi kalendarin për mbledhjet e ardhshme, çështje që lidhen me aspekte logjistike, apo dhe planifikimin në terma afatgjatë. Komiteti bashkëdrejtohet nga Zyra e Komisionerit, në cilësinë e Sekretariatit të ICIC, dhe autoriteti organizator i Kanadasë. Anëtarë të këtij organizmi janë autoriteti homolog i Kosovës, si organizator i Konferencës gjatë vitit 2028, organizator i mëparshëm nga Sierra Leone, si dhe në të bën pjesë edhe z. Toby Mendel, nga Qendra për Ligj dhe Demokraci në Kanada.

Zyra e Komisionerit në KosovaPAR 2026, për transparencën dhe mbrojtjen e të dhënave personale në administratën publike

Transparenca dhe mbrojtja e të dhënave personale janë pjesë thelbësore e transformimit digjital të administratës publike. Ky ishte mesazhi kryesor i kontributit të Zyrës së Komisionerit në konferencën ndërkombëtare KosovaPAR 2026, me ftesë të Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike të Republikës së Kosovës. Autoriteti shqiptar u përfaqësua në këtë aktivitet me znj. Rovena Sulstarova, Drejtor i Përgjithshëm për të Drejtën e Informimit, e cila kontribuoi në panelin "Transparenca, Qasja në Informacion dhe të Drejtat në Administratën Publike Moderne".

Duke ndarë përvojën e Zyrës së Komisionerit, znj. Sulstarova theksoi se: "një administratë publike digjitale nuk është domosdoshmërisht një administratë transparente. Shërbimet më të shpejta dhe më të aksesueshme nuk garantojnë vetvetiu që qytetarët të kuptojnë kriteret e vendimmarrjes apo mënyrën se si përpunohen të dhënat e tyre personale. Për këtë arsye, përdorimi i teknologjisë dhe i inteligjencës artificiale duhet të shoqërohet me transparencë proaktive dhe informacion të qartë e të kuptueshëm mbi veprimtarinë e institucioneve publike".





KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

www.idp.al

Diskutimet u përqendruan në zbatimin efektiv të kuadrit ligjor, publikimin proaktiv të informacionit të përditësuar dhe integrimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe sigurisë që në fazën e projektimit të sistemeve digjitale. Vëmendje e veçantë iu kushtua mbikëqyrjes njerëzore në përdorimin e inteligjencës artificiale dhe forcimit të kapaciteteve profesionale të administratës, si kushte për garantimin e të drejtave dhe rritjen e besimit të qytetarëve në shërbimet publike digjitale.

Paneli u moderua nga z. Pajtim Gashi, Drejtor i Programit në Institutin Kombëtar Demokratik (NDI), me pjesëmarrjen e znj. Krenare Sogojeva-Dermaku, Komisionere në Agjencinë e Informimit dhe Privatësisë së Republikës së Kosovës, z. Lirim Bllaca, Drejtor Operativ në TRECCERT dhe znj. Kaltrina Haxha, Drejtore e Përputhshmërisë dhe Oficere e Mbrojtjes së të Dhënave në ProCredit Bank Kosova.

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe atij për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik

Vendim Nr. 41, datë 12.10.2026, për urdhërimin e autoritetit publik Urdhri i Psikologut për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Vendim Nr. 42, datë 20.10.2026, për urdhërimin e autoritetit publik Bashkia Dimal për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Vendim Nr. 43, datë 26.10.2026, për urdhërimin e autoritetit publik Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Vendim Nr. 44, datë 26.10.2026, për urdhërimin e autoritetit publik Agjencia e Zhvillimit të Territorit për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Vendim Nr. 45, datë 28.10.2026, për zbatimin e masave administrative ndaj autoritetit publik Bashkia Dimal për Programin e Transparencës dhe Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Vendim Nr. 46, datë 28.10.2026, për zbatimin e masave administrative ndaj autoritetit publik Bashkia Këlcyrë për Programin e Transparencës.

Vendim Nr. 47, datë 28.10.2026, për zbatimin e masave administrative ndaj autoritetit publik Spitali Rajonal Gjirokastër për Programin e Transparencës.

Rekomandim Nr. 61, datë 19.10.2026, për Programin e Transparencës të autoritetit publik Instituti i Integrimit të Ish të Përndjekurve Politikë.

Rekomandim Nr. 63, datë 20.10.2026, mbi zbatimin e ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Rekomandim Nr. 64, datë 20.10.2026, mbi zbatimin e ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik" nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale: